Марија Ивановска

Iris Marion Young,
**On Female Body Experience,**
Oxford University Press, 2006.

*On Female Body Experience* на Ајрис Мерион Јанг е збирка есеи кои за главна тема ја имаат женската отелотвореност. Текстовите приложени во оваа книга се пишувани во период од дваесетина години, а неколку од нив претставуваат класични четива во феминистичката литература. Анализирани, критикувани, препрочитувани, текстовите го поминаа тестот на времето, но и ден-денес претставуваат жариште на нови полемики и расправи.

Вредноста на оваа збирка не се состои само во нивното повторно препечатување, ниту во изборот на есеите како збирка; книгата можеме да ја оцениме како преглед на теоријата на Јанг за женската отелотвореност, но и како вовед во една специфична област на феминистичката литература, имено, вовед во теоријата на *живото женско телесно искуство*. Збирката, со својата хронолошка специфичност и инвентивност е одличен ресурс за вовед во феминистичката перспектива за оваа проблематика. Некои од постарите текстови, како што се „Throwing Like a Girl", „Pregnant Embodyment", „Woman Recovering Our Clothes" и „Breasted Experience" се одличен пример за спојот на феноменолошката и феминистичката перспектива, теориски позиции кои Јанг како феминистичка мислителка ги искористува во своите испитувања.

Marija Ivanovska

Iris Marion Young,
**On Female Body Experience,**
Oxford University Press, 2006.

*On Female Body Experience* nga Ajris Mejrion Jangu është përmbledhje esesh të cilat për temë kanë shtatninë femërore. Tekstet e paraqitura në këtë libër janë shkruar në një periodë prej 20 vjetësh, ndërsa disa syresh paraqesin tekste klasike në literaturën feministe. Të analizuara, të kritikuara, të lexuara dhe të rilexuara, tekstet e kaluan testin e kohës, por edhe sot e kësaj dite paraqesin vatër të polemikave dhe të debateve të reja.

Vlera e kësaj përmbledhjeje nuk qëndron vetëm në rishtypjen e saj, as në zgjedhjen e eseve në përmbledhje; librin mund ta vlerësojnë si një pasqyrë të teorisë së Jangut për shtatninë femërore, pra, hyrje në teorinë e *përvojës jetësore trupore femërore*. Përmbledhja, me specificitetin e saj kronologjik si dhe me invencën e veçantë është një resurs i shkëlqyeshëm për hyrje në perspektivën feministe për të këtë problematikë. Disa nga tekstet e vjetra, siç janë "Throwing Like a Girl," "Pregnant Embodyment," "Woman Recovering Our Clothes" dhe "Breasted Experience" janë shembull i shkëlqyeshëm për lidhjen e perspektivës fenomenologjike dhe feministe, pozicione teorike të cilat Jangu si mendimtare feministe i shfrytëzon me kërkimet e saj.

Доколку се обидеме да го објасниме пристапот кон темите, можеме да забележиме дека тој во голема мера е комплексен. Испитувајќи ја женската отелотвореност, Јанг своите согледби ги темели емпирски, што значи дека во извесна мерка нејзините ставови не се однесуваат на сите жени. Женското живо телесно искуство е испитувано од повеќе аспекти. Во текстот „Throwing Like a Girl", Јанг го испитува женското движење и просторност, облекувањето („Woman Recovering Our Clothes"), бременоста („Pregnant Embodyment"), менструацијата („Menstrual Meditations"). Иако, како што спомнавме, сите овие искуства не може да се однесуваат на сите жени подеднакво, тие, во принцип, сепак се обележја на женското живо искуство. Затоа Јанг во своите есеи го акцентира индивидуалниот аспект на таквото доживување. Таа истовремено го додава и моментот на социјалното опкружување, потенцирајќи дека субјектноста на женската отелотвореност не се исцрпува во апстрактната индивидуалност, туку женската отелотворена индивидуалност се посматра како момент на секојдневната материјална социјална отелотвореност.

Интересно е да се забележи дека и покрај партикуларноста во пристапот, Јанг користи и метода со која во крајна инстанца ги генерализира наодите на анализата. Методата што ја користи Јанг се темели и произлегува од Лис Иригаре (Luce Irigaray). Главните карактеристики на методата се состојат во тоа што се испитува женствениот начин на постоење, онака како што тоа е конструирано од патријахалните норми, а потоа се анализира позицијата на жените втурнати во тој начин на постоење, односно нивната социјализација да живеат женствено. Следниот момент во методата е да се процени дали и на кој начин оваа позиција на женскост може да послужи како стојалиште, точка на гледиште од каде ќе се крити-

Nëse orvatemi ta shpjegojmë qasjen në këto tema, mund të vërejmë se ajo në një masë të madhe është komplekse. Duke hulumtuar shtatninë femërore, Jangu shqyrtimet e saja i bazon në mënyrë empirike, që do të thotë se në një farë mase qëndrimet e saj nuk kanë të bëjnë me të gjitha femrat. Përvoja e gjallë femërore e shtatnisë është hulumtuar nga shumë aspekte. Në tekstin "Throwing Like a Girl", Jangu e hulumton lëvizjen femërore, hapësirën e saj, veshmbathjen ("Woman Recovering Our Clothes") shtatëzaninë ("Pregnant Embodyment") menstruacionet ("Menstrual Mediations"). Edhe pse, siç theksuam, të gjitha këto përvoja nuk kanë të bëjnë në të gjitha gratë njësoj, ato, parimisht, megjithatë, janë shenja të përvojës së gjallë femërore. Për këtë arsye rangu me esetë e veta e akcenton aspektin individual të përjetimit të tillë. Ajo njëherësh e shton edhe momentin e rrethimit social, duke theksuar se subjektiviteti i shtatnisë femërore nuk shpenzohet në individualitetin abstrakt, por individualiteti shtator femëror vëzhgohet si moment i shtatnisë së përditshme materiale e sociale.

Është interesante të theksohet se edhe krahas partikularitetit në qasje, Jangu shfrytëzon edhe një metodë në të cilën në instancë të fundit i përgjithëson rezultatet e analizës. Metodën që e shfrytëzon Jangu bazohet dhe del nga Lis Irigare (Luce Iligaray). Karakteristikat kryesore të kësaj metode qëndrojnë në faktin se hulumtohet mënyra femërore e ekzistimit, ashtu siç është konstruktuar nga normat patriarkale, kurse më vonë analizohet pozicioni i femrave të futura kësisoj në ekzistim, përkatësisht socializmi i tyre që të jetojnë në mënyrë femërore. Momenti tjetër i metodës është që të vlerësohet se a mundet dhe sa mundet në këtë mënyrë ky pozicion të shërbejë si pikë qëndrimi, pikëvështrimi nga e cila do të kritikohet relacionet dominante sociale,

куваат доминантните социјални релации, и на крај, исходиште на методата е да се открие дали е можно да се генерираат алтернативни идеали на родова еднаквост во политичко-социјалните контексти.

Оваа тензија во методолошката позиција произлегува од неколку околности. Првата е историска. Бидејќи оваа компилација датира од пред околу дваесет години, во тоа време, како што Јанг признава, доминантна, ако не и единствена метолошко-теориска позиција е феноменолошкиот егзистенцијализам. Како таква, феноменолошката позиција содржи партикуларистичка позиција на испитување, фокусирајќи се на поединечното, посебното што една личност го носи во доживувањето и искуството на конкретни животни ситуации. Оттаму и партикуларизмот во понудените текстови. Меѓутоа, нормативниот и општиот карактер на ставовите и увидите во текстовите произлегуваат од нормативниот карактер на феминизмот, но и од методолошко-теорискиот карактер на феминистичката мисла која се темели на дихотомијата пол/род.

Концепцијата на книгата одговара на сегашните состојби во феминистичката терија. Незадоволството со дистинкцијата пол/род, односно сѐ пораспространетото мислење за лимитираноста на овие категории, го прави повторно актуелен концептот на живото тело во феноменолошка смисла. Во уводниот текст „Lived Body vs. Gender: Reflections on Social Structure and Subjectivity“, врз примерот на гледиштето на Торил Мои (Toril Moi) за живото тело, Јанг ги прикажува историјата и проблемите на концептите на *род* и на *живо̄то̄ тело*. Причината зошто овој текст е воведен, иако е најнов во оваа збирка, е тоа што самата поставеност на текстовите остензивно ја прикажува тековната проблематика на женската

dhe në fund, përfundimi i metodës është që të zbulohet se a është e mundur të gjenerohen idealet alternative të barabarësisë gjinore në kontekstet politike-sociale.

Ky tension në pozicionin metodologjik del nga disa rrethana. E para është historike. Meqenëse ky kompilim rrjedh nga një kohë prej para 20 vjetësh, aso kohë, siç pranon Jangu, pozicionin dominant, nëse jo edhe i vetmi metodologjik-teorik, është ekzistencializmi fenomenologjik. Si i tillë, pozicioni fenomenologjik përmban pozicionin partikular të hulumtimit duke u fokusuar në individuale, të veçantë të cilën një personalitet e bart në përjetimin dhe përvojën e situatave konkrete jetësore. Së këndejmi, edhe partikularizmi në tekstet e ofruara. Ndërkaq, karakteri normativ dhe i përgjithshëm i qëndrimeve dhe i teksteve që i kemi nëpër duar dalin nga karakteri normativ i feminizmit, por edhe nga karakteri metodologjik-teorik i mendimit feminist i cili bazohet në dihotominë seks/gjini.

Koncepcioni i librit u përgjigjet situatave të tashme në teorinë feministe. Pakënaqësia me distinksionin seks/gjini, përkatësisht mendimi gjithnjë e më i përhapur për limitimin e atyre kategorive, e bën sërish aktual konceptin e trupit të gjallë në kuptimin fenomenologjik. Në hyrje të tekstit “Lived Body vs. Gender: Reflections on Social Structure and Subjectivity”, në shembullin e pikëpamjes së Toril Moit (Toril Moi) për trupin e gjallë, Jangu e paraqet historinë dhe problemet e koncepteve të *gjinisë* dhe të *trupit të gjallë*. Shkaku se pse ky tekst është hyrës, ndonëse është më i riu në këtë përmbledhje, është se vet vendosja e teksteve në mënyrë ostenzive e tregon problematikën aktuale të shtatnisë femërore. Domethënë, tekstet duhet të lexohen metagjuhësisht,

отелотвореност. Значи, текстовите треба да се читаат метајазички, така што, освен основното значење, тие во сегашниов контекст на феминистичката мисла имаат и едно конструктиво показно теориско значење.

Какво е значењето и користа од еден феноменолошки концепт, како што е концептот на живото тело после незадоволството со категориите на полот и родот, и какво било значењето на таа феноменолошка категорија пред нивната употреба, може само да се покаже во една остензивна компарација. Тоа е тактиката на Јанг во расправата за сè позачестените предлози за промена на концептуалната парадигма во корист на концептот на живото тело. Според Јанг, категоријата на живото тело, живото искуство всидрено во феноменолошката философска традиција е недоволно да ги опфати сите аспекти на отелотвореноста. Феноменолошката анализа на отелотвореноста се насочува на индивидуалните аспекти на личноста на партикуларноста на ситуацијата, и во таа смисла, во целост ги опфаќа оние аспекти на живото искуство за кои другите теориски приоди се неспособни. Меѓутоа, живото искуство, онака како што го разбира феноменологијата, се темели на наивниот хуманизам, на метафизички сфатената личност која е способна да избира и одлучува. Според Јанг, тоа е недостаток на феноменологијата. Таа не може да ги согледа структурните и системските влијанија на општеството врз позицијата на личноста, субјектот. Затоа категоријата на родот, како категорија која ги опфаќа токму овие аспекти е нужна, и на сегашно ниво на феминистичката мисла незаменлива.

Иако не експлицитно, се чини дека Јанг нуди еден приод кон женската отелотвореност како симбиоза на феноменолошката категорија на живото тело и



kështu që, përveç domethënies themelore, ata në kontekstin e tashëm të mendimit feminist kanë edhe një dëshmi konstruktive me domethënie teorike.

Se çfarë është rëndësia dhe dobia nga një koncept fenomenologjik, siç është koncepti i trupit të gjallë pas pakënaqësisë me kategoritë e gjinisë dhe seksit, dhe çfarë domethënie të kësaj kategorie ka pasur para përdorimit të tyre, mund të tregohet vetëm në një krahasim ostenziv. Kjo është taktika e Jangut në debatin për propozimet gjithnjë e më të shpeshta për ndryshimin e paradigmës konceptuale në dobi të konceptit të trupit të gjallë. Sipas Jangut, kategoria e trupit të gjallë, përvoja e gjallë e vendosur në traditën e filozofisë fenomenologjike është e pamjaftueshme që ti përfshinë të gjitha aspektet e shtatnisë. Analizë fenomenologjike e shtatnisë kahëzohet drejt aspekteve individuale të personalitetit të partikularitetit të situatës, dhe në këtë kuptim, në tërësi i përfshinë të gjitha aspektet e përvojës së gjallë për të cilat qasjet tjera teorike janë të paafta. Ndërkaq, përvoja e gjallë, ashtu siç e kupton fenomenologjia, bazohet në humanizmin naiv, në personalitetin e kuptuar metafizikisht që është i aftë të zgjedhë e të vendos. Sipas Jangut, kjo gjë paraqet një mangësi të fenomenologjisë. Ajo nuk mund ti shqyrtojë ndryshimet strukturore e sistematike të shoqërisë në pozicionin e personalitetit, subjektit. Për këtë arsye kategoria e gjinisë, si kategori e cila i përfshinë pikërisht këto aspekte është e nevojshme, dhe nivelin e tashëm të mendimit feminist edhe i pazëvendësueshëm.

Edhe pse në mënyrë eksplicite, duket se Jangu ofron një qasje në shtatninë femërore si simbioz e kategorisë fenomenologjike të trupit të gjallë dhe e dihotomisë

дихотомијата пол/род. Но, нивната употреба бара постојана свесност за ограниченоста и доменот на овие категории кога ги употребуваме независно една од друга. Во крајна линија, употребата на категоријата *живо тело после* категориите пол/род и употребата на категориите пол/род *пред* категоријата *живо тело* е навистина продуктивен начин да се проникне во секојдневноста на женското искуство во својата посебност и општост.

seks/gjini. Mirëpo, përdorimi i tyre kërkon vetëdije të vazhdueshme për kufizimin dhe domenin e këtyre kategorive kur i përdorin pavarësisht nga njëra-tjetra. Në fund të fundit, përdorimi i kategorisë *trup i gjallë* pas kategorive seks/gjini dhe përdorimi kategorive seks/gjini *para* kategorisë *trupi i gjallë* me të vërtetë është një mënyrë produktive që të depërtohet në përvojën e përditshme femërore, në veçantinë dhe në përgjithësinë e saj.

Përkthim: Xhabir Ahmeti